

ishtë të të shoh ty të buzëqeshur, e kënaqësia ime në çdo moment që të kërkoj nga unë ndonjë gjë të të përgatis, e kjo ishte kulmi i gëzimit tim.

Kaluan shumë netë e ditë e unë isha në këtë gjëndje; shërbëtore, pa të meta, gjidhënese, pa u ndalur, punonjëse, pa pushuar... deri u rrite dhe u bëre djalosh. E kur tek ti fil-luan të dukën shenjat e burrërisë, fillova djathtas e majtas që të kërkoj një vajzë, të cilën e kërkoje. Erdh koha e *martesës tënde*, zemra ima gati sa nuk plasi dhe nga syri shpërthyen lotët; nga gëzimi për jetën tëndë të re dhe e pikëlluar për ndarjen tënde.

Filluan të kalojnë momente të rënda, tashmë sikur nuk je im bir, të cilin e njoh, më nuk më njeh dhe i ke harruar obligimet që i ke ndaj meje...!

Kalojnë ditët e unë nuk të shoh e as zërin nuk ta dëgjoj, e injorove atë që të ka rritur ty me të gjitha të mirat.

O biri im!

Une nuk kërkoj nga ti përveç diç simbolike, së paku me jep tek ti pozitën e shokëve të tu të largët, dhe pozitën e atyre që më së paku i rrespekton..

O biri im!

Shpejto në pendim të sinqertë para se të bëhët vonë!

E lus All-llahun [subhanehu ve teala] të na ruaj shoqërinë tonë nga mëkatët, të vazhdojë begatija e Tij ndaj neve, të na largon ndëshkimin prej neve, të na furnizojë me përkujtimin e Tij të shumtë dhe falënderim ndaj Tij, dhe adhurim të mirë, Ai, vërtetë ka fuqi mbi çdo send.

Marrë nga webfaqja fetare:

www.saaaid.net

Këshilla e nënës dhënë djalit të saj të pakujdesshëm



Njëashtu i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Të thënurit: “HASBIJA-LLAHU VE NI’ME-L-VEKILU” (më mjafton që kam All-llahun, Ai është mbrojtësi më i mirë), është siguri nga çdo frikë.”* (Dejlemiu dhe Ebu Nuajmi prej Sheddad ibën Evsit [radijall-llahu anhu] hadithi është i dobët)

I Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] thotë: (Ai që thotë) **“LA HAVLE VE LA KUVVETE ILA BILAH”** (ska ndryshim dhe fuqi pa ndihmën e all-llahut) kjo është shërim nga nëntëdhjetë e nëntë sëmundje, nga të cilat më e lehta është shqetësimi (brennga). (Ibën ebi Dunja prej Ebu Hurejres [radijall-llahu anhu] hadithi është i dobët)

Gjithashtu I Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Kush është i përpiktë në istigfar (kërkimin e faljeve të gjynabeve)... All-llahu nga çdo vështirësi do t’i bën rrugëdalje, nga çdo*

brenge dhe shqetësim do t’i bën çlirim si dhe do ta furnizojë nga nuk e kujton.”

(Ebu Davud, Ibën Maxhe prej Ibën Abbasit [radijall-llahu anhu] hadithi është i dobët)

Motra ime e dashur, para se t’i drejtohesh njeriut... drejtoju All-llahut të Madhëruar, sepse vetëm Ai është që posedon fuqi për të larguar shqetësimin dhe brengën tënde, si dhe Ai është i cili posedon fuqi t’i largojë vështirësitë tuaja dhe bren-gosjen tënde.

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fle-tushka përmban ajete kur’anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
Rr. Stiv Naumov 7 / 18
Tel. ++389 (02) 32 23-654
1000, Shkup



Si t’i largosh shqetësimet?



O biri im!

Kjo është një këshillë e plagur e nënës së ngratë. E kam shkruar këtë letër, e turpëruar, duke u matur disa herë e duke menduar, duke e kapur lapsin disa herë, por lotët nuk më lanë, më penguan lotët disa herë deri sa edhe zëmra më rënkonte.

O biri im!

Pas kësaj jetë të gjatë e kam parë se je njeri i drejtë, i mençur e i kujdesshëm. Kërkoj nga ti që ta lexosh këtë letër, e pasi ta lexosh, nëse deshiron, grise ashtu siç m'i ke grisur ndjenjat e zemrës time më herët!

O biri im!

Para 25 vitëve ishte një ditë e ndriçuar në jetën time, atëherë kur më lajmëroi motra medicinale së vërtetë unë isha shtatzënë.

O biri im!

Të gjitha nënat këtë fjalë e kuptojnë mirë së ç'farë dua të them. Ajo ditë ishte e bashkuar më gëzim e lumturi, kur me to filluan dhimbjet e formimit të shpirtit dhe trupit tënd. Pas këtij përgëzimi të kam mbajtur nëntë muaj në barkun tim me gëzim e lumturi. Gjatë kësaj kohe jam ngritur më vështirësi, kam fjetur më vështirësi, kam ngrënë më vështirësi, kam marrë frymë më vështirësi... por megjithë këto vështirësi nuk u shujt dashurija ime ndaj teje e as gëzimi im ndaj teje. Por, dita ditës u shtua dashuria yte dhe malli për ty aq më shumë më merrte.

O biri im!

Të kam bartur lodhje mbi lodhje, dhimbje mbi dhimbje, u gëzosh me lëvizjet tua, me shtimin e peshës tënde, edhe pse kjo bartje ka qenë edhe më e rëndë për shkak

të peshës tënde. Vërtetë, këto dhimbje kan qenë të gjata deri sa ka ardhur mëngjesi e unë nuk kisha fjetur tërë natën, e as sytë nuk më ishin mbyllur prej dhimbjeve dhe vështirësive, e prej frikës që nuk e përshkruan lapsi e që nuk mund t'a shpreh as gjuha. E kam parë shumë herë vdekjen më sytë e mi. Derisa erdh momenti të dalësh në këtë botë, dhe u përzien lotët e të qajturit tënd me lotët e gëzimit tim, dhe këtu morën fund dhimbjet dhe plagët e mia.

O biri im!

Kanë kaluar shumë vite prej jetës tënde e unë të kam mbajtur në zemrën time, të kam pastruar me duart e mia, prehrin tim e bëra shtrat për ty, gjiri im ishte ushqimi yt. Natën nuk fleja vetëm që ti të fleshë, kurse ditën u lodhësja që ti të gëzohesh. Pushimi im, çdo ditë

Një vajzë e takon shoqën e saj të brengosur dhe i thotë:

Vajza e parë: Përse të shoh të brengosur?!

Vajza e dytë: Shqetësimet dhe brengat më kanë kapluar dhe ma kanë ngushtuar gjoksin.

Vajza e parë përsëri e pyeti: A i je ankuar dikujt nga shqetësimet që i ke?

Vajza e dytë: Jo, vall-llahi, ti je e para të cilës po ia hap shpirtin tim dhe vetëm ty po t'i shpalosi shqetësimet e mia, duke shpresuar se do të më ndihmosh që t'i largoj nga shpirti im.

Vajza e parë: Unë nuk jam Ajo e cila mund t'i largoj shqetësimet e tua!

Vajza e dytë: (me brengë): Po ti je shoqja ime e vetme e sinqertë!

Vajza e parë: Po, ...por Ai i cili largon brengat dhe shqetësimet është All-llahu i Lartëmadhëruar... dhe është dashur që para se të mbështetesh në mua së pari të

mbështetesh në All-llahun [subhanehu ve teala].

Vajza e dytë: Të mbështetem në All-llahun e Madhëruar...? Po, ç'ti them Atij që të më largojë brengat dhe shqetësimet?

Vajza e parë: Neve na mësoi i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] se si t'i drejtohem i Atij me lutjet tona që Ai të na largojë brengat dhe shqetësimet.

Vajza e dytë: pyeti me shpejtësi: Të lutem, më trego pra për këtë lutje!

Vajza e parë: i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në raste të vështirësive thoshte:

“LA ILAHE IL-ALL-LLAHU EL-ADHIM EL HALIM LA ILAHE IL-LALL-LLAHU RABBUL ARSHI-L-ADHIM. LA ILAHE ILA-LLAHU RABBUSSEMAVATI VE RABBUL-ERDI VE RABBUL-ARSHI-L-KERIM.”

(Nuk ka zot pos All-llahut të

Lartëmadhëruar, të Urtit. Nuk ka Zot pos All-llahut, pronarit të Arshit. Nuk ka Zot pos All-llahut. Zot i qiejve, tokës dhe Arshit).

Transmeton Buhariu dhe Muslimi

I Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] poashtu thotë: “A dëshironi t'u njoftojë për një gjë?”

Kur të zbrat ndonjë vështirësi tek ndonjëri prej jush, apo ndonjë fatëkeqësi e kësaj bote, le të lutet me këte, e lutja e tillë do t'i ndihmojë që t'i largojë ato. I Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] tha: “Ajo është duaja (lutja) e Dhen-Nunit (të cilën e ka bërë në barkun e peshkut): “LA ILAHE ILA ENTE, SUBHANEKE, INNI KUNTU MINE-DHALIMIN” (Nuk ka Zot pos teje. Ti je i pastër nuk ke të meta. Unë i bëra padrejtësi vetes sime).

Transmeton Tirmidhiu dhe Hakimi hadithi është sahih